

KËRKESË
Nr. 608, datë 3.3.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “JULIAN AHMETI”

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitetet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: larguar.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH-VL-2019 001381-5, datë 30.5.2019, për subjektin Julian Ahmeti “Internet Kafe”, me adresë: rruga “Mitat Haxho”, lagjja nr. 4, Sarandë.

KRYEINSPEKTOR
Lorenc Rexho

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-VL-2019-001381-5

Datë 30.5.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-VL-2019-001381-2, datë 30.5.2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “Juljan Ahmeti”, NIPT L73719802U, përfaqësues i autorizuar i subjektit “Juljan Ahmeti”, prej datës 30.5.2019 deri në datën 30.5.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 30.5.2019 dhe e njoftoi në datën 30.5.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar, 7 3.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar, neni 11/4, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 10 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

- Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave.

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Jola Osmeni

ID_



Pavjola Zeneli

ID_0412080008



Personi i autorizuar i subjektit:
Juljan Ahmeti

Refuzoi


Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti "Juljan Ahmeti" ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.